



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

*Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike,
Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm*

Nr. 201/3 Prot.

Tiranë, më 27/05/ 2016

V E N D I M
Nr.55, Datë 27/05/2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS,
MBI VLERËSIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE
RREGULLSHMËRISË SË SHPENZIMEVE
LIDHUR ME EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE
PËR PERIUDHËN 01.01.2014 DERI MË 31.12.2015.

Pasi u njoha me aktverifikimin dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi mbi vlerësimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së shpenzimeve lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore” për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE.

Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi vlerësimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së shpenzimeve lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, u konstatua se për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015, nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, janë ekzekutuar dy vendimeve gjyqësore (ndaj Z., në vlerën 1,877,685 lekë dhe subjektit “C”, në vlerën 52,157,918 lekë). Nga auditimi i procedurës së pagesës së bërë ndaj subjektit “C”, rezultoi që detyrimi ndaj këtij subjekti ishte shkaktuar si pasojë e procedurave të zhvilluara në lidhje me prokurimin “Ndërtimi i kampusit të ri universitar” për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi që në përfundim të procedurës së hapur të prokurimit, KVO kishte shpallur si fitues operatorin ekonomik “C”. dhe kishte skualifikuar operatorin ekonomik “K” për mospërmbushje të kriterëve të vlerësimit.

Operatori ekonomik “K”, në ezaurim të ankimimit në AK në lidhje me këtë vendim të KVO, ka vazhduar procedurën e ankimimit në Komisionin e Prokurimit Publik. KPP në shqyrtim të ankesës së operatorit ekonomik “K” ka vendosur kualifikimin e këtij operatori dhe shpalljen e tij fitues.

Pas marrjes së njoftimit për shpalljen fitues të operatorit ekonomik “K” operatori ekonomik “C” i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative, e cila ka vendosur detyrimin e të paditurit Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës të dëmshpërblejë paditësit shoqëria “C” dëmin pasuror të shkaktuar (humbja e shkaktuar dhe fitimi i munguar) në vlerën **52,157,918 lekë**. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit.

Pagesa e shumë prej 52,157,918 lekë për “C” është kryer në zbatim të shkresës së Ministrisë së Financave nr. 7584/73, datë 07.07.2015 “Akordim i fondeve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore”, për vlerën 52,157,918 lekë, referuar zbatimit të aktit nr. 662 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë “Vendim mbi lëshimin e urdhrin të ekzekutimit” të Vendimit nr. 3177, dt. 28.03.2013 lënë në fuqi me vendimin nr. 4014, datë 31.10.2014 të Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Rekomandim: Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, duhet të ezaurojë në çdo rast të drejtën dhe detyrimin e tij si autoritet kontraktor për të ankimuar administrativisht ose në Gjykatë çdo vendim të Komisionit të Prokurimit Publik, për të cilin autoriteti kontraktor është i bindur që është dhënë në kundërshtim me legjislacionin mbi prokurimin publik, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 64/2, pika 2 dhe 66/3, pika 1, të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet:

“Autoritetet kontraktore duhet të zbatojnë vendimin e dhënë ose të kërkojnë rishikimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga marrja dijani për vendimi...”

Palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë”

Në vazhdimësi

B. TË TJERA

Ky Vendim do ti përcillet për njohje Z. MSh (Pedagog i Fakultetit të Studimeve Profesionale të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës) në cilësinë e subjektit i cili vuri në lëvizje Kontrollin e Lartë të Shtetit për kryerjen e këtij auditimi tematik, nëpërmjet shkresës nr. 109, datë 26.01.2016.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

K R Y E T A R

Bujar LESKAJ